

# PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER AKTIVITETIN



**SUBJEKTI : «IPNOS» SH.P.K.**

**Klasifikimi i projektit:** Në bazë të Ligjit nr.52/2020 te date 30.04.2020 per disa ndryshime te ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet perfshihet ne Shtojca I, Industrite prodhuese te komponenteve elektrik **piken ID 9.2," Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."**

**ADMINISTRATOR I SUBJEKTIT: SILVIO CARLO MAIDA**

Hartoi materialin Studio Mjedisore « D.E.A. PROJEKT » Sh.p.k.

**VENDODHJA:** Durres,Xhafzotaj,Xhafzotaj,Autostrada Durres – Tirane,Km 6,  
Zona Kadastrale 3852,Nr.Pasurie14/100,Vol 19,Fq 117,Prane stacionit znoteknik,Kodi postar 2013.

## **PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

- 1. HYRJE**
- 2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR**
- 3. INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHET PROJEKTI**
- 4. SKICA DHE PLANIMETRITE E OBJEKTEVE TE PROJEKTT DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTIT**
- 5. PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLOGJIKE,PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.**
- 6. INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJE,SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET, SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.**
- 7. INFORMACION PER LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PERRETH ZONES SE PROJEKTIT**
- 8. INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KOSIDERATE PER SA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO TE PERDORET.**
- 9. TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.**
- 10. INFORMACION MBI SHKARKIMET NE MJEDIS NGA AKTIVITETI**
- 11. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE**
- 12. PROGRAMI MONITORIMIT**
- 13. INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUHTJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.**

## 1. HYRJE

Mjedisi eshte burimi i gjithçkaje per te cilen njerezit kane nevojë per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomiko-social, prandaj duhet nje menaxhim sa me mire i mjedis.

Vendi yne eshte anetare i nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomik-social-mjedisor, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë periudhës së zhvillimit të projektit.

Ky Raport do te paraqese nga njera ane rendesine e zbatimit te projektit **piken ID 9.2, "Prodhimi i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."** përkrahimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutese për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundshme këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmejt tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Të paraqesë realizimin e ketij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin "e zhvillimit të qëndrueshëm". Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij. Kjo edhe per vete faktin se kjo zone eshte nje zone mjaft e rendesisheme, jo vetem per pozicionin gjeografik qe ka,por edhe per vlerat dhe resortet qe mban.

Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte dhe nje pjese e kesaj hapesire eshte siperfaqe e gjelber. Qarkullimi, hyrjet e daljet ne aktivitet behen nepermjet rruges qe kalon prane projektit. Ne kete zone kemi shume aktivitete te ndryshme per aresye pozicioni si dhe lehtesise se komunikacionit.

**Godina ne te cilen ndodhet aktiviteti, eshte prone private e Shoqerise "IPNOS" Sh.p.k.**

Ky objekt shtrihet ne nje terren te rrafshet ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

Shoqeria **"IPNOS" Sh.p.k. me administrator z.Silvio Carlo Maida** është një subjekt i cili prej vitesh zhvillonë aktivitetin e tij ekonomik te **"PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE'** në përputhje me legjislacionin ne Shqiperi.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka nje qarkullim te dendur te automjeteve. Gjithashtu pozicionim buze rruges kryesore si edhe rruga hyrese dhe dalese per ne aktivitet kriojon lehtesira per zhvillimin e ketij aktiviteti.

## 2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

### 2.1 Pershkrimi i projektit

Qëllimi i Shoqërisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave për **'PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE »** dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e aktivitetit.

**Aktiviteti ka për qëllim." PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE »**

Subjekti " **IPNOS**" Sh.p.k. e ushtron këto aktivitete prej vitesh dhe është pajisur me të gjithë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e kësaj aktiviteti. Aktualisht Subjekti për ushtrimin e kësaj aktiviteti disponon Leje Mjedisore të Tipit B.

**Referuar Shtojcës 1 të ligjit 52/2020 datë 30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR" aktiviteti PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE » klasifikohet për të pajisur me Leje Mjedisore të tipit B (Shtojca 1, pika ID 9.2," Prodhimi i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."**

Për këto arsye Subjekti " **IPNOS**" Sh.p.k. po ndjek procedurat për të pajisur me Leje Mjedisore të Tipit B.

### 2.2 Te dhena teknike të Aktivitetit

Shoqëria " **IPNOS**" Sh.p.k. me administrator z.**Silvio Carlo Maida**, është i regjistruar në QKR me datë 05.11.2020, dhe është pajisur me certifikatën e regjistrimit si person juridik, me numër

**NIPT M 02306026 C**, si dhe ka dokumentacionin e kontratave që ka lidhur për furnizimin me ujë dhe energji elektrike ku midis veprimtarive të tjera ka dhe **"PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE "**.

Pranë aktivitetit kalon **Autostrada Durrës - Tiranë**. Në këtë zonë nuk ka patur dhe tani as nuk ka asnjë bimë të lartë (dru pyjorë ose pemë frutore).

Aktiviteti është i pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm për këto aktivitete duke plotësuar kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

Aktiviteti është i mbyllur nga pjesa mbrapa, me hyrje dalje.

Në zonën ku do të zhvillohet ky aktivitet ka shtëpi banimi, shkollë, dhe aktivitete të tjera sociale kulturore, por që nuk mund të demtohen nga zhvillimi i kësaj aktiviteti nga subjekti.

Objekti ku zhvillohet aktiviteti është i sheshtë, në kuotën e rruges.

E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti është sistemuar, asfaltuar duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor me cilesor, dhe ka ndikuar ne permirsimin e ndotjes mjedisore dhe permirsimin e pamjes vizuale.

Subjekti, për vazhdimin e ushtrimit te aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij, **Referuar Shtojces 1 te ligjit 52/2020 date 30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR"** aktiviteti **PRODHIM DHE KRYERJE E MBESHTJELLEVE TE MOTORVE ELEKTRIKE, REALIZIMI I IMPJANTEVE DHE PAISJEVE ELEKTRIKE** » klasifikohet per tu pajisur me **Leje Mjedisi te tipit B (Shtojca 1, pika ID 9.2," Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."**

### 2.3 Vendodhja e aktivitetit

Subjekti "**IPNOS**" Sh.p.k. me administrator **z.Silvio Carlo Maida** ushtron aktivitetin ne Adresen: **Durres,Xhafzotaj,Xhafzotaj,Autostrada Durres – Tirane,Km 6,Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 14/100,Vol 19,Fq 117,Prane stacionit z Zoteknik,Kodi postar 2013.**

**Godina ne te cilen ndodhet aktiviteti, është prone private e marre me qera nga Shoqeria "IPNOS" Sh.p.k.**

Ky objekt shtrihet ne nje terren te rrafshet ndersa prona është e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk është i ndjeshem.

Ndertesa ku zhvillohet aktiviteti ka nje **siperfaqe totale te prones 4526 m2**, dhe te godines **1690.08 m 2** e rregjistruar ne Z.V.R.P. ne zonen kadastrale **Nr. 3852**,me Nr.Pasurie **14/100** ne regjistrin hipotekor. Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte dhe nje pjese e kesaj hapësire është siperfaqe e gjelber.

Ne kete zone kemi shume aktivitete te ndryshme per aresye pozicioni si dhe lehtesise se komunikacionit.

E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti është sistemuar, asfaltuar duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor me cilesor, dhe ka ndikuar ne permirsimin e ndotjes mjedisore dhe permirsimin e pamjes vizuale.

Kjo zone nuk është habitat per specie te rendesishme te flore dhe faunes.

Gjithashtu pozicionimi i aktiviteti ekzistues ne **Autostraden Durres - Tirane** lehtesira ne aksesimin e tij si edhe per automjetet e zjarrfikses ne rast te aksidenteve te mundeshme si renia e zjarrit apo ambulancave ne rastet e aksidenteve me pasoje ne shendetin e punonjesve.

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke pasur parasysh perparesit si:

- Furnizimi me uje;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtesi ne aksesim nga automjetet ( automjetet per ngarkim shkarkim, zjarrfikset dhe ambulancat)

**Kondicionet urbane.**

**Objekti i ndertuar eshte ne forme "katerkendeshi"**

**Siperfaqia totale e sheshit ku zhvillohet aktiviteti 4.526 m2**



**Pamje e vendosjes se aktivitetit**

<b>Kordinatat e objektit ku zhvillohet aktiviteti</b>		
<b>Pikat</b>	<b>X</b>	<b>Y</b>
<b>1</b>	<b>4375965.12</b>	<b>4580591.53</b>
<b>2</b>	<b>4375978.65</b>	<b>4580599.22</b>
<b>3</b>	<b>4375969.89</b>	<b>4580568.51</b>
<b>4</b>	<b>4375992.33</b>	<b>4580571.05</b>

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER DIANA F. HOXHA



U LINDURUA  
TAXA E FULLES

#### VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 10.03.2021, para meje Notere DIANA F. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4/RAJONI 1, SKENDERBEJ/EGNATIA, PALLATI 1182, u paraqit personalisht:

#### DEKLARUES/IT:

Shoqëria "IPNOS" shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS M02306026C, datë 05.11.2020; me seli në adresë Rruga Abdyl Frasheri, Ndertesa Nr.8, Hyrja 7, Ap.25, 1019, përfaqësuar nga Administratori SILVIO CARLO MAIDA, atësia GIUSSEPPE, amësia ROMINA, shtetas Italian, lindur në NAPOLI dhe banues në ITALI, me adresë Itali, lindur më 08/05/1964, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. YB5522427 dhe nr. personal YB5522427.

#### DEKLARUES/IT:

Arjan Tivari, atësia Reshit, amësia Mejreme, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Ruga "aleksander Goga", Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Durrës; Durrës; 2001; Durrës, lindur më 29/05/1955, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 035040401 dhe nr. personal F50529121Q, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 2126, Nr. kol 1304, hartuar nga noter DIANA HOXHA, në datë 30/09/2019, nga përfaqësues Erald Tivari, atësia Arjan, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 09/08/1990, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J008090640 dhe .

#### DEKLARUES/IT:

Klarita Tivari, atësia Riza, amësia Lule, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Durrës, me adresë Rruge Panjohur; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 23/06/1962, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me ID nr. 035337666 dhe nr. personal G25623124V, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 2126, Nr. kol 1304, hartuar nga noter DIANA HOXHA, në datë 30/09/2019, nga përfaqësues Erald Tivari, atësia Arjan, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 09/08/1990, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J008090640.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "KONTRATE QIRAJE" më datë 01/03/2021, në Shqipëri nga IONOS shpk dhe Arjan Tivari dhe Klarita Tivari", bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.


Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
DIANA F. HOXHA



Fq. 1

KONTRATE QIRAJE	CONTRATTO D'AFFITTO
<p>Sot me date 01.03.2021 (Dymije e njezet e nje) ne Durres midis paleve kontraktuese lidhet kjo kontrate qiraje si me poshte:</p> <p><b>QIRADHENES:</b> Arjan Tivari, i biri i Reshit-iti datelindjes 29.05.1955, lindur dhe banues ne Durres, lagja 9, rruga "Lilo Zeneli", Durres, mbajtese i nr. Personal F50529121Q, perfaqesuar me prokuren e posacme me nr.2126 rep dhe nr.1304 kol., date 30.09.2019, noter Diana Hoxha ,nga z.Erald Tivari, shtetas shqiptar, lindur me 09.08.1990 ne Durres, mbajtes i leternjoftimit me nr.personal J00809064O.</p> <p><b>QIRAMARRES:</b> Shoqeria "IPNOS" SHPK, me NUIS M02306026C, me seli ne adresen: Tirane Tirane TIRANE Rruga Abdyl Frasherit, Ndertesa nr.8, hyrja 7, ap.25, 1019, me perfaqesues ligjor Z. Silvio Carlo Maida , qytetare Italian, lindur ne 08/05/1964 ne Napoli, mbajtese e leternjoftimit nr.YB5522427</p>	<p>Oggi, il 09.03.2021 (duemila venti uno) a Durazzo tra le Parti contraenti viene stipulato questo contratto d'affitto come segue:</p> <p><b>LOCATORE:</b> Arjan Tivari, figlio di Reshit, nato il 29.05.1955, nativo e abitante a Durazzo, quartiere nr. 9, via "Lilo Zeneli", Durazzo ,titolare del no. Personale F50529121Q, rappresentato tramite la procura speciale n.2126 rep , e n.1304 kol., data 30.09.2019 ,nataio Diana Hoxha dal sign. Erald Tivari , cittadino albanese, nato il 09.08.1990 a Durazzo, in possesso della carta d'identita con n.personale J00809064O.</p> <p><b>CONDUTTORE:</b> Societa "IPNOS" SHPK, con NUIS M02306026C, con sede legale all'indirizzo: Tirane Tirane TIRANE Rruga Abdyl Frasherit, Ndertesa nr.8, hyrja 7, ap.25, 1019, con rappresentante legale la Sig Silvio Carlo Maida, cittadino italiano, nato a Napoli, il 08/05/1964, titolare della Carta d'Identita nr. YB5522427.</p>
<p><b>1. OBJEKTI I KONTRATES</b></p> <p>Qiradhenesi deklarone se eshte pronar i ligjshem i pasurise <b>magazine</b> e ndodhur ne adresen Xhafzotaj, Durres, me siperfaqe 1100.07 m2 sipas lejes se ndertimit miratuar me date 24/07/2019 me nr.prot 2660 , Nr. 14/91, ZK 3852, Vol.18, faqe 96 , me siperfaqe te pronës 470 m2. Nr. 14/100, ZK 3852, Vol.19, faqe 117 , me siperfaqe te pronës 4526 m2 dhe 1690.08 m2 ndertesë ekzistuese. Në pasurinë me nr. 14/129, ZK 3852, Vol.25, faqe113 , me siperfaqe të pronës 3730 m2.</p>	<p><b>1. OGGETTO DEL CONTRATTO</b></p> <p>Il locatore dichiara di essere legittimo proprietario del bene immobile <b>magazzino</b> situata all'indirizzo: Xhafzotaj, Durazzo, con superficie 1100.07 m2 come il permesso di costruzione dalla comune data 24/07/2019 ,nr.prot 2660, Nr. 14/91, ZK 3852, Vol.18, pagina 96 , con superficie di propieta 470 m2. Nr. 14/100, ZK 3852, Vol.19, pagina 117 , con superficie di propieta 4526 m2 dhe 1690.08 m2 propieta esistente . Nr. 14/129, ZK 3852, Vol.25, pagina113 , con superfice di propieta 3730 m2. Nr. 14/130, ZK 3852, Vol.25, pagina 127, con superfice di</p>



2







<p>nga momenti i ketij ndryshimi.</p> <p><b>4. E DREJTA E PREFERENCES</b></p> <p>4.1. Ne fund te afatit te qirase, ne rast se qiradhenesi kerkon te lidhe perseri kontrate qiraje per sendin objekt te kesaj kontrate, qiramarresi gezon te drejten per t'u preferuar ne raport me personat e trete qe pretendojne te lidhin kontrate qiraje me qiradhenesin.</p> <p><b>5. E DREJTA E PERTERITJES</b></p> <p>5.1. Kontrata e qirase do te quhet e perteritur ne rast se pas mbarimit te afatit te kontrates, qiramarresi vazhdon ta mbaje ne perdorim sendin dhe qiradhenesi nuk paraqet ndonje kundershtrim per kete gje. Ne keto raste kontrata do te ripertierhet edhe per nje afat te ri me po ato kushte si e meparshmeja.</p> <p><b>6. NENQIRAJA</b></p> <p>6.1. Qiramarresi mund te ushtroje te drejten e nenqirase ne rast se per kete gje ka marre pelqimin me shkrim nga Qiradhenesi. Lidhur me shoqerite e kontrolluara dhe/ose me pjesemarrje nga Qiramarresi nuk do te kerkohet ky miratim. Zgjidhja apo shpallja e pavlefshme e kontrates se qirase sjell efekte juridike edhe per nenqirane.</p> <p><b>7. GARANCIA</b></p> <p>7.1. Qiramarresi do te derdhe ne llogarine bankare te Qiradhenesit nje garanci prej 5000 (pese mije) euro. Kjo vlere do te mbahet ne rast se Qiramarresi nuk respekton detyrimet e kontrates si dhe per cdo demtim te mundshem qe mund t'i shkaktohet objektit. Garancia do te paguhet brenda 10 (dhjete) ditesh nga nenshkrimi kontrates.</p> <p>7.2. Ne perfundim te kontrates, pas verifikimit te inventarit te objektit me procesverbal te firmosur nga perfaqesuesit e paleve si dhe pas verifikimit te te gjitha detyrimeve te qiramarresit, kjo garanci do t'i kthehet Qiramarresit brenda 15 (diteve ne llogarine e tij bankare nese cdo detyrim rezulton i kryer nga Qiramarresi.</p> <p><b>8. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE</b></p> <p>TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHENESIT</p> <p>➤ Qiradhenesi eshte i detyruar ti dorezoje</p>	<p>cambiamento.</p> <p><b>4. IL DIRITTO DI PREFERENZA</b></p> <p>4.1. Alla fine del termine d'affitto, se il Locatore chiede di stipulare nuovamente contratto d'affitto in oggetto del presente contratto, il Conduttore gode il diritto di preferenza in rapporto a terzi che pretendono di stipulare il contratto d'affitto con il Locatore.</p> <p><b>5. IL DIRITTO DI RINNOVO</b></p> <p>5.1. Il Contratto d'affitto verrà considerato rinnovato nel caso in cui dopo la sua risoluzione, il Conduttore continua a tenerlo in uso e il Locatore non presenta qualche contestazione per questa azione. In questi casi il contratto verrà rinnovato per un altro termine con le stesse condizioni come le precedenti.</p> <p><b>6. SUBAFFITTO</b></p> <p>6.1. Il Conduttore potrà esercitare il diritto di subaffitto se per questa azione ha ottenuto l'approvazione per iscritto del Locatore. Riguardo alle Società Controllate e/o con partecipazione non verrà richiesto l'approvazione. La risoluzione o la proclamazione invalida del contratto d'affitto comporta effetti giuridici anche per il subaffitto.</p> <p><b>7. GARANCIA</b></p> <p>7.1. Il Conduttore verserà nel Conto corrente del Locatore una garanzia di 5000 (cinque mila) euro. Questo valore verrà trattenuto nel caso in cui il Conduttore non rispettasse gli obblighi del contratto e anche per ogni eventuale danno che potrà essere causato all'oggetto. La garanzia verrà pagata entro 10 (dieci) giorni dalla firma del contratto.</p> <p>7.2. Alla risoluzione di questo contratto, dopo la verifica dell'inventario dell'oggetto con l'apposito Verbale firmato dai rappresentanti delle Parti e anche la verifica di tutti gli obblighi, questa garanzia sarà restituita all'Conduttore entro 15 giorni nel suo conto corrente se ogni altro obbligo risulta effettuato dal Conduttore.</p> <p><b>8. DIRITTI E OBBLIGHI DELLE PARTI</b></p> <p>I DIRITTI E GLI OBBLIGHI DEL LOCATORE</p> <p>➤ Il Locatore è obbligato di consegnare l'oggetto al</p>
---	--

5

<p>qiramarresit sendin ne kohen e caktuar ne kontrate dhe ne ate gjendje qe i pergjigjet qellimit per te cilin eshte dhene me qira.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Qiradhenesi gjate vazhdimet te qirase eshte i detyruar te kryejte te gjitha ndreqjet dhe riparimet qe jane thelbesore, te domosdoshme dhe te nevojshme per ta mbajtur sendin ne ate gjendje qe i pergjigjet qellimit te dhenies me qira.</li><li>➤ Qiradhenesi mban pergjegjesi jo vetem per te metat e sendit para lidhjes se kontrates, por edhe per ato qe shfaqen gjate perdorimit te tij, ose gjate kohe vazhdimet te kontrates.</li><li>➤ Qiradhenesi detyrohet te garantoje qiramarresin jo vetem per gezimin e qete te sendit gjate periudhes se afatit te kontrates se qirase, por ta garantoje edhe nga pretendimet e pronesis se qe mund te kene te tretet ndaj sendit te dhene me qira. Po keshtu edhe ne rast se ka ndonje pretendim ndonje i trete apo bashkepronar, qiradhenesi duhet ta garantoje qiramarresin qe kontrata do te zbatohet sipas kushteve te saj dhe qiradhenesi eshte i detyruar te zgjidhe me te tretet apo me bashkepronaret cdo mosmarreveshje qe lidhet me pronesine e sendit, pa cenuar interesat e qiramarresit.</li><li>➤ Qiradhenesi eshte i detyruar ti paguaje taksat ne masen dhe brenda afateve ligjore te percaktuara nga ligjet apo aktet nenligjore. Perjashtohen tatimet dhe taksat te cilat i perkasin aktivitetit te qiramarresit. Tatimi mbi te ardhurat do te llogaritet dhe paguhet sipas percaktimeve ne nenin 3 me siper.</li><li>➤ Te njoftoje Qiramarresin me shkrim per cdo ndryshim te adreses se tij, brenda nje jave nga data e ketij ndryshimi.</li></ul> <p><b>TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Qiramarresi eshte i detyruar te marre sendin ne perdorim dhe ta perdore ate sipas destinacionit te percaktuar ne kontrate ose nga qellimi i paleve.</li><li>➤ Qiramarresi eshte i detyruar qe ne momentin e lidhjes se kesaj kontrate qiraje, do te lidhe kontraten e energjise elektrike si edhe kontraten e ujesjelles-kanalizimeve ne emer te Qiramarrestit.</li><li>➤ Qiramarresi eshte i detyruar te ktheje sendin ne gjendjen qe eshte marre, pas perfundimit te afatit te kontrates.</li><li>➤ Ne mungese te nje pershkrimi ne lidhje me gjendjen e sendit ne momentin e lidhjes se</li></ul>	<p>tempo determinato al contratto e in quello stato che corrisponde allo scopo per il quale è stato affittato.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Il Locatore durante la continuazione dell'affitto è obbligato di effettuare tutte le correzioni e le riparazioni che sono essenziali, utili e necessarie per contenere in quello stato che corrisponde allo scopo per il quale è stato affittato.</li><li>➤ Il Locatore è responsabile non solo per le carenze dell'oggetto prima della stipulazione del contratto ma anche per quelle che compariranno durante la sua usura o durante la continuazione del contratto.</li><li>➤ Il Locatore è obbligato di garantire al Conduttore non solo per il godimento tranquillo dell'oggetto durante il periodo del termine del contratto d'affitto, ma di garantirlo anche dalle pretese delle proprietà che potranno avere i terzi nei confronti dell'oggetto lasciato in affitto. Nello stesso modo anche in caso se c'è una pretesa taluno terzo o comproprietario, il Locatore deve garantire al Conduttore che il contratto verrà attuato secondo le proprie condizioni e il Locatore è obbligato risolverla con i terzi o comproprietari ogni controversia connessa con la proprietà dell'oggetto, senza pregiudicare gli interessi del Conduttore.</li><li>➤ Il Locatore è obbligato di pagare le imposte e le tasse nella misura ed entro il termine prestabilite nella legge e gli atti sub legali. Vengono escluse le imposte e le tasse che appartengono all'attività del Conduttore. L'imposta sull'utile verrà calcolato e pagato secondo le determinazioni all'articolo "CANONE E PAGAMENTO" sopramenzionato.</li><li>➤ Il Locatore deve notificare per iscritto per ogni cambiamento del suo indirizzo, entro una settimana dalla data di questo cambiamento.</li></ul> <p><b>I DIRITTI E GLI OBBLIGHI DEL CONDUTTORE</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Il Conduttore è obbligato di prendere l'oggetto all'usura e di usarlo secondo le destinazione determinata nel contratto o dallo scopo delle Parti.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato che al momento della stipulazione di questo contratto che, firmerà un contratto per l'energia elettrica e di acqua e servizi igienico-sanitari contratto a nome di Conduttore.</li><li>➤ Il Conduttore è tenuto a restituire l'oggetto nello stato che viene presa dopo la fine della durata del contratto.</li><li>➤ In mancanza di una descrizione riguardo allo stato dell'oggetto al momento della stipula del contratto, si presumerà che l'oggetto è presa in</li></ul>
--	--

<p>ne menyre te njeanshme ne rastet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a) Qiramarrësi nuk zbaton kushtet themelore te kesaj kontrate.</li><li>b) Qiramarrësi nuk ka paguar qiranë për dy muaj njëri pas tjetrit, përjashtuar rastet kur vonesa e pagesës është pasojë e një force madhore.</li><li>c) Qiramarrësi nuk ka paguar detyrimet kontraktore te energjise, ujit, dhe tatimit mbi qirane për dy muaj njëri pas tjetrit, përjashtuar rastet kur vonesa e pagesës është pasojë e një force madhore.</li></ul>	<p>terme in modo unilaterale nei casi seguenti:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a) a-Il Conduttore non eseguisce le condizioni fondamentali di questo contratto.</li><li>b) b-Il Conduttore non ha pagato l'affitto per due mesi consecutivi, escluso i casi quando il ritardo del pagamento è conseguenza di una forza maggiore.</li><li>c) c-Il Conduttore non ha pagato gli obblighi contraenti dell'energia, acqua e imposte sull'affitto per due mesi consecutivi escluso i casi quando il ritardo del pagamento è conseguenza di una forza maggiore.</li></ul>
<p><b>10. PENALITETE</b></p> <p>10.1. Nese Qiramarrësi nuk respekton afatet e njoftimit per zgjidhjen e kontrates para dates se perfundimit te saj ai penalizohet me vleren e garancise prej 5000 Euro.</p> <p>10.2. Nese Qiramarrësi kerkon te zgjidhe kontraten brenda 18 muajve nga nenshkrimi kontrates atehere ai penalizohet me vleren e garancise.</p> <p>10.3. Nese Qiramarrësi nuk ka paguar detyrimet kontraktore te Qirase mujore brenda afatit te cdo fillim muaji, atehere Qiramarrësi eshte i detyruar te paguaj 1% te vleres se qerases mujore per cdo dite vonese te pagese se ketyre detyrimeve.</p> <p>10.4. Nese Qiramarrësi nuk ka paguar detyrimet kontraktore te energjise elektrike, ujit dhe takses mbi qerane brenda afateve ligjore sipas kontrates perkatese atehere Qiramarrësi eshte i detyruar te paguaj 1% te vleres se qerases mujore per cdo dite vonese te pagese se ketyre detyrimeve.</p> <p>10.5. Nese Qiramarrësi nuk respekton kushtet themelore te kesaj kontrate me pasojte zgjidhjen e saj, me perjashtim te percaktimeve te nenit "Zgjidhja e Kontrates" atehere Qiramarrësi eshte i detyruar ti demshperbleje si penalitet Qiramarrësit te gjithe vleren e permiresimeve te kryera nga Qiramarrësi.</p>	<p><b>10. LE PENALITA</b></p> <p>10.1. Se il Conduttore non rispetta i termini per la risoluzione del contratto prima della data del termine di essa, egli sarà penalizzato con il valore della garanzia di 5000 Euro.</p> <p>10.2. Se il Conduttore cerca di risolvere il contratto entro 18 mesi dalla firma del contratto, allora è penalizzato con il valore della garanzia.</p> <p>10.3. Se il Conduttore non ha pagato gli obblighi dell'affitto mensile entro il termine all'inizio di ogni mese, allora il Conduttore è costretto di pagare 1% del valore dell'affitto mensile per ogni giorno di ritardo dei pagamenti di questi obblighi.</p> <p>10.4. Se il Conduttore non ha pagato gli obblighi contraenti dell'energia, acqua e imposte sull'affitto entro il termine legale secondo il rispettivo contratto allora il Conduttore è obbligato di pagare 1% del valore dell'affitto mensile per ogni giorno di ritardo dei pagamenti di questi obblighi.</p> <p>10.5. Se il Conduttore non rispetta le condizioni essenziali di questo contratto con conseguenza la sua risoluzione secondo l'articolo "La Risoluzione del Contratto" allora il Conduttore è obbligato di risarcire le penalità al Locatore tutto l'importo dei miglioramenti effettuati dal Conduttore.</p>
<p><b>11. KOMUNIKIMI MES PALEVE</b></p> <p>11.1. Menyra e komunikimit midis Qiramarrësit dhe Qiradhenesit do te jete nepermjet postes elektronike E-mail ne adresat e meposhtme te cilat do te jene te disponueshme ne cdo moment:</p> <p>Qiradhenesi: eraldtivari@yahoo.com Qiramarrësi: silviocarlo65otmail.it</p>	<p><b>11. COMUNICAZIONE TRA LE PARTI</b></p> <p>11.1. I mezzi di comunicazioni tra il Conduttore e il Locatore avverranno tramite la posta elettronica E-mail ai seguenti indirizzi le quali saranno disponibili in qualsiasi momento:</p> <p>Il Locatore: eraldtivari@yahoo.com Il Conduttore: silviocarlo65otmail.it</p>

<p>kontrates, do te prezumohet se sendi eshte marre ne dorezim ne gjendje te mire.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Qiramarresi është përgjegjës për humbjen ose përkeqësimin e sendit që ndodhë gjatë periudhës se qirase madje edhe nese keto demtimit janë shkaktuar nga zjarri.</li><li>➤ Qiramarresi është përgjegjës për humbjen ose demtimin e sendit të shkaktuar nga një zërit që ai ka lejuar, qoftë edhe perkohesisht për perdorimin apo gezimin e sendit.</li><li>➤ Ne rast se qiramarresi është ne vonese për kthimin e sendit, ai detyrohet të paguajë qira deri ne momentin e dorezimit të sendit.</li><li>➤ Qiramarresi është i detyruar të paguajë cmimin e qirase ne afatin dhe ne vleren e percaktuar nga palet ne kontrate.</li><li>➤ Qiramarresi është i detyruar të njoftoje menjehere qiradhenesin ne lidhje me pretendimet e te treteve mbi sendin.</li><li>➤ Qiramarresi ka te drejte t'i beje permiresime sendit, me kusht qe ne perfundim te kontrates, objekti te kthehet ne gjendjen fillestare pa e demtuar ate dhe pa kerkuar kthimin e vleres se shpenzimeve te bera.</li><li>➤ Qiramarresi ka te drejte qe ne perfundim te afatit te qirase, te marre me vete permiresimet qe i ka bere sendit ne qofte se permiresimet jane te tilla qe mund te hiqen ose te ndahen nga sendi pa e demtuar ate, pervec rasteve kur pronari pranon ti mbaje vete shtesat.</li><li>➤ Qiramarresi detyrohet te paguajë shpenzimet per energjine elektrike dhe ujin per ambientin e marre me qira, per kohen e qirase cdo fund muaji.</li><li>➤ Qiramarresi është i detyruar të paguajë cdo takse tjeter qe rendon mbi biznesin.</li><li>➤ Qiramarresi nuk ka te drejte qe ta jape me nenqira pronen personave te trete pa pelqimin me shkrim te Qiradhenesit.</li><li>➤ Qiramarresi është i detyruar të ruajë e mirembaje ambientin e marre me qira dhe t'ia dorezoje ate qiradhenesit ne perfundim te afatit te kesaj kontrate.</li></ul> <p style="text-align: center;"><b>9. ZGJIDHJA E KONTRATES</b></p> <p>9.1. Qiramarresi mund te zgjidhe kete kontrate para dates se perfundimit te saj duke njoftuar Qiradhenesin me shkrim jo me pak se 120 dite perpara vendimit te tij per te zgjidhur kontraten e qirase.</p> <p>9.2. Qiradhenesi mund te zgjidhe kontraten para afatit</p>	<p>consegno a buon stato.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Il Conduttore è responsabile per la scomparsa o peggioramento dell'oggetto che succederà durante il periodo di locazione anche se questi danni sono causati dal fuoco.</li><li>➤ Il Conduttore è responsabile per la scomparsa o peggioramento dell'oggetto causato dalle persone che egli ha permesso, anche se temporaneamente all'usura o godimento dell'oggetto.</li><li>➤ Se in caso che Il Conduttore è in ritardo alla restituzione dell'oggetto, egli sarà obbligato a pagare l'affitto fino al momento della restituzione dell'oggetto.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato di pagare il canone di locazione al termine e al valore prestabilito dalle parti al contratto.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato di notificare immediatamente il Locatore riguardo alla pretese dei terzi sull'oggetto.</li><li>➤ Il Conduttore ha diritto di effettuare miglioramenti all'oggetto, con la condizione che alla risoluzione del contratto, l'oggetto verrà restituito allo stato iniziale senza danneggiare esso e senza richiedere la restituzione del valore delle spese fatte.</li><li>➤ Il Conduttore ha diritto che alla conclusione del termine dell'affitto, di prendere con se i miglioramenti fatti se i miglioramenti sono tali da potersi togliersi o dividersi dall'oggetto senza danneggiarlo, escluso i casi quando il proprietario di accetta di tenere di persona le aggiunzioni.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato di pagare le spese di energia elettrica e l'acqua per l'ambiente preso in affitto per il tempo di locazione ogni fine mese.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato di pagare ogni altra tasse che attiene allo business.</li><li>➤ Il Conduttore non ha diritto di darlo in subaffitto la proprietà ai terzi senza l'approvazione del Locatore.</li><li>➤ Il Conduttore è obbligato di preservare e contenere l'ambiente presa in affitto e di consegnare quello al Locatore alla conclusione del termine di questo contratto.</li></ul> <p style="text-align: center;"><b>9. LA RISOLUZIONE DEL CONTRATTO</b></p> <p>9.1. Il Conduttore può risolvere questo contratto prima della data del termine di essa notificando il Locatore per iscritto non meno di 120 giorni anteriormente la sua decisione di risoluzione del contratto di locazione.</p> <p>9.2. Il Conduttore può risolvere il contratto prima del</p>
--	--

<p>11.2. Cdo ndryshim i adreses email apo fizike te paleve do te njoftohet branda 7 diteve pales tjetër.</p>	<p>11.2. Ogni cambiamento dell'indirizzo mail o fisica tra le parti verrà notificata all'altra entro 7 giorni.</p>
<p><b>12. TE NDRYSHME</b></p>	<p><b>12. VARIE</b></p>
<p>12.1. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete kontrate, per çdo mosmarreveshje midis paleve do t'i referohemi dispozitave te neneve 801 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.</p>	<p>12.1. Per quanto non è previsto nel presente contratto, per qualsiasi controversia tra le parti si farà riferimento alle disposizioni di cui agli articoli 801 e seguenti del Codice Civile della Repubblica d'Albania.</p>
<p>12.2. Per çdo mosmarreveshje midis paleve ne realizimin e kesaj kontrate palet bien dakord qe cdo konflikt ta zgjidhin me mirekuptim dhe pajtim. Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen me pajtim konflikti do te zgjidhet ne rruge gjyqesore dhe organi kompetent eshte Gjykata Rrethit Gjyqesor Durres.</p>	<p>12.2. Per qualsiasi controversia tra le parti per l'attuazione del presente contratto le parti si impegnano a risolvere le controversie in via amichevole e la conciliazione. Se le controversie non siano risolte amichevolmente la controversia sarà risolto attraverso la via legale e l'organo competente è il Foro di Durazzo.</p>
<p>12.3. Kontrata mbahet ne tre kopje te njejta dhe origjinale, nje kopje i dorezohet qiradhenesit, nje kopje i dorezohet qiramarrësit dhe nje kopje mbahet ne zyren noteriale.</p>	<p>12.3. Il Contratto verrà tenuto in tre copie identiche originali, una copia è consegnata al Conduttore e una copia è conservata presso l'ufficio notarile .</p>
<p>12.4. Aneksi 1 dhe dokumentet qe i bashkëngjiten kësaj Kontrate përbëjnë pjesë të pandarë të saj.</p>	<p>12.4. L'annesso 1 e i documenti che sono allegati al presente contratto costituiscono parte integrante di esso.</p>
<p>Kontrata pasi u lexua nga palet me vullnetin e tyre te plote dhe te lire nenshkruhet si me poshte.</p>	<p>Il contratto, una volta che viene letto dalle parti con la loro piena e libera volontà viene sottoscritto come segue:</p>
<p><b>QIRADHENES</b></p> 	<p><b>IL LOCATORE</b></p> 
<p><b>QIRAMARRRES</b></p> 	<p><b>IL CONDUTTORE</b></p> 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 1254069  
PËR

DURRES 3852

14/1 Volumi 19 Faqe 118

XHAFZOTAJ / DURRES

Loji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 4526m<sup>2</sup>

Nga kjo : Sa Truall 4526m<sup>2</sup> Nga kjo 1639,08m<sup>2</sup> %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Pjesa	Adresa
	<u>1</u>	<u>DURRES</u>

është pronar i 14/100

janë bashkëpronarë sipas \_\_\_\_\_

është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_


kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_ L \_\_\_\_\_ J \_\_\_\_\_ P \_\_\_\_\_

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas paraqitjes nga (të) interesuarit (t) më datë 24.12.2015 Nr. 28418

Data e lëshimit të çertifikatës 20.01.2016

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
JURGIS QYRBJA



### 3. INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHET PROJEKTI


Qarku i Durrësit zë një sipërfaqe prej 76 000 ha dhe shtihet në Ultësirën perëndimore të Shqipërisë Qëndrore.

Qarku përfshin dy rrethe, Durrës dhe Krujë.

Qarku i Durrësit ka 351,899 banorë dhe 90,939 familje me 495 banorë për km<sup>2</sup>.

Rreth 75 % e popullsisë është përqendruar në rrethin e Durrësit. Ndryshimet demografike janë me të dukshme në Rrethin e Durrësit dhe veçanërisht në qytetin e Durrësit, Njesite Administrative Sukth, Rrashbull, Xhafzotaj e Katundi i Ri.

Rrethi i Durrësit shtrihet nga Kepi i Rodonit në veri deri tek Përroi i Agait pas Shkëmbit të Kavajës me një sipërfaqe 430 km<sup>2</sup> dhe lartësi mesatare 2-6 m mbi nivelin e detit. Qyteti zë pjesën perëndimore me koordinata 41° e 18' e 40' gjerësi gjeografike veriore deri në 19° e 26' e 21' gjatësi gjeografike lindore me sipërfaqe 1.626 ha. Kufijtë – Vija e përgjithshme kufitare është 121,3 km (52,4 km kufij tokësorë, 61,8 km kufij detarë dhe 7,1 km kufij lumorë). Kufizohet në veri me Rrethin e Kurbinit, me Rrethin e Tiranës e Rrethin e Krujës në lindje e verilindje, Rrethin e Kavajës në jug e juglindje dhe me Detin Adriatik në perëndim.



Reshjet –

Zona e Durrësit karakterizohet si zone mesdhetare, me dime rrethësisht dhe të bute dhe vere të thate.

Faktorët që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

Prania e detit, i cili siguron një dimër të butë dhe vere të nxehtë

Influenca e cikloneve dhe anticikloneve, të cilat e rregullojnë klimën në të gjithë territorin.

Sasia mesatare e reshjeve është 963,4 mm/vit ose 116 ditë në vit. Relievi është kryesisht fushor dhe me përbërje të pakta kodrinore, me lartësi deri 200m mbi nivelin e detit. Klima është mesdhetare.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 16°C, diellzimi numëron 2.026 orë në vit.




#### 4. SKICA DHE PLANIMETRITE E OBJEKTEVE TE PROJEKTT DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTIT







PLANIMETRIA E KATIT PERDHE - OBJEKTI 2 SH I 150  
SHKURTY: PERSHIRJE PERDHE SHKURTY 2.1 SHI 150  
ADRESA: RAUSTRA




**PRERJA B-B SH 1:150**



**PRERJA B-B Sh 1:100**





## 5. PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLOGJIKE, PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.

Shoqeria "IPNOS" Sh.p.k. ushtron aktivitetin e saj ne fushen per "**Prodhimin dhe kryerjen e mbeshtjelljeve te motoreve elektrike, realizimin e impianteve dhe paisjeve elektrike.**"

Kjo Shoqeri e ka filluar aktivitetin e saj ne vitin 2020.

Makinerite e linjes dhe lenda e pare sigurohet kryesisht nga Italia.

Produkti perfundimtar shkon per eksport (ka kontrata kryesisht me furnitoret e lendes se pare).

Shoqeria ka siguruar nje klientele te rregullt, cka vjen nga cilesia e mire e prodhimit.

Shoqeria "IPNOS" Sh.p.k. ndodhet ne **Xhafzotaj, Autostrada Durres – Tirane. Durres**. Kjo zone eshte e miratuar per zhvillimin e aktiviteve ekonomike dhe industriale.

Objekti furnizohet me energji elektrike sipas kontrates se lidhur me OSHEE.

Nje gjenerator me fuqi 120 Kw eshte disponibel per rastet e nderprerjes se energjise nga rrjeti elektrik.

Uji i nevojshem sigurohet nga njeti i ujesjellsit te qytetit.

Instalimet elektrike dhe ndricimi jane realizuar sipas standarteve bashkekohore duke lejuar nje funksionim optimal te procesit ne teresi, dhe mjaft komod dhe per punonjesit.

Linja dhe zgjidhja brenda hapësirës është projektuar mjaft kompakte duke lejuar nje zhvillim funksional te aktivitetit.

Teknologjia per prodhimin dhe mbeshtjelljen e motoreve elektrike jane teknologji me paisje bashkekohore si per kryerjen e procesit teknologjik ashtu edhe per treguesit e mbrojtjes se mjedisit sipas standarteve te Komunitetit Europian.

Funksionimi i tyre jepet ne menyre te detajuar ne pershkrimin e procesit teknologjik.

Vendodhja e objektit favorizohet nga nje infrastrukture e gatshme dhe lidhet me rrugen automobilistike, si per transportimin e lendeve te para ashtu dhe per shperndrujen e produktit te gatshem.

Gjithe njesia prodhim-magazinim eshte e vendosur ne nje hapësire te mjaftueshme per nje proces optimal. Vendosja e gjithe paisjeve te nevojshme eshte zgjidhur ne menyre racionale, funksionale dhe shume praktike, si per realizimin e prodhimit ashtu dhe per personelin punonjes.

Lenda e pare, vernike te llojit AQUATHERM BC - 365, letra e plastifikuru, teli i bakrit, struktura metalike e motorrave sigurohen nga importi dhe jane te nje cilesie shume te mire gje qe garanton realizimin e produkteve cilesore dhe brenda standartit.

### Procesi Teknologjik

Linja e prodhimit dhe mbeshtjelljes se motoreve elektrike eshte ndertuar dhe po menaxhohet nga nje staf me pervojte disa vjecare ne kete sektor te industrise duke zbatuar nje teknologji bashkekohore si per cilesine e prodhimit ashtu dhe per treguesit e ndotjes se mjedisit.

### *Sektoret Kryesore te Linjes*

- Magazinimi i lendeve te para
- Vaska e llakimit
- Furra e tharjes
- Procesi i presimitte motorave
- Procesi i "qepjes" se motorave
- Bobinatrice per format e bakrit qe futen ne motorr
- Inserter per te avolxhuar motorrat
- Kompjuter kolaudimi
- Kompresor ajri
- Tegolatrice
- Taglia fondocava

Procesi teknologjik i prodhimit dhe mbeshtjelljes se motoreve elektrike eshte i bazuar ne nje te knonologji bashkekohore komode per personelin punonjes. Ne menyre te shkurtuar gjithë procesi mund te permblihet ne keto etapa kryesore:

1) Izolimi fillestar i statorit qe kryhet me leter te plastifikuar, e cila importohet ne topa te perpunuar dhe trajtohet vetem ne gjatesit qe nevojitet dhe me pas e vendoset ne stator.

2.) Llakimi i telit te bakrit kryhet ne vasken e llakimit ku telat e bakrit te vendosur ne kosha te vecante dhe zhyten ne llak. Per llakim perdoret AQUATHERM BC - 365 qe eshte nje llak poliester i modifikuar per tu tretur ne uje duke e kthyer ate ne nje produkt miqesor ndaj ambientit dhe duke mos krijuar shkarkime kimike te rrezikshme (pH i tij varion nga 7.5 - 9). Cikli i llakimit eshte nje cikel i mbyllur tek i cili nuk ka shkarkime ne mjedis. Mbas ciklit te llakirnit kontrollohet pesha e specifikave e llakut ne vaske dhe ne rast te rritjes se saj behet korrigjimi duke e holluar me uje deri sa te arrije ne  $1050 \pm 50$  kg/m<sup>3</sup>. Gjithashtu nga vaskat e llakimit nuk kemi shkarkime ne mjedis mbasi keto verniqe riperdoren.

Dimesionet e vaskes jane:

Gjatesia 2100 mm

Gjeresia 800 mm

Thellesia 900 mm

Vaska eshte e ndare ne dy zona te poshtmen me lartesi 500 mm dhe te sipermen me gjatesi 400 mm, ajo eshte e ndertuar nga nje strukture llamarine, ne te kalohet ajer me presion 0.5 bar per te kryher ciklin e qarkullimit te llakut dhe per te realizuar llakimin homogjen. Presioni kontrollohet nepermjet reduktori presioni te lidhur me nje manometer. Mbas procesit te llakimit qe zgjat rreth 15 minuta koshat vendosen mbi nje kolektor tek i cili grumbullohen njedhjet e llakut (te cilat rifuten ne vaken e llakimit). Ne kapanonin industrial dhe vecanerisht ne kete pjese do te instalohen aspiratore te cilet do realizojne qarkullimin e ajrit duke mos krijuar probleme per shendetin e puntoreve dhe procesin teknologjik.







*Pamje e vaskes se llakimit*

3) Mbas llakimit koshat futen ne furren tharese ku temperatura nuk i kalon  $160\text{ }^{\circ}\text{C}$  temperature ne te cilen nuk krijohen kushte per shperberjen e komponenteve te veriqeve qe perdoren. Furra eshte tipit "Tabo"konstruktuar sipas normave te Komunitetit Europian 98/37 CEE si dhe direktivave te makinerive 73/23/CEE me permasa 2200 X 2200 X 2200 mm ose volum te pergjithshem rreth  $10.5\text{ m}^3$   
Produkti ne varesi te specifikave teknike ka nje cikel tharje qe varion nga 2 - 8 ore. Qarkullimi i ajrit kryhet nga 1 ose 2 ventilatore me te cilet ne fazen e pare ate te tharjes qarkullojne rreth  $700\text{ m}^3/\text{ore}$  ndersa ne fazen e dyte qe eshte nxjenja e produktit ne furre qarukullojne rreth  $350\text{ m}^3/\text{ore}$ . Lenda djegse qe perdoret eshte gaz i leget (metan ose propan) dhe gjate ciklit te djegies lirohet dioksid karboni dhe avuj uji.  
Fuqia e bruatoreve (koka e flakes) eshte  $50.000\text{ kcal/h}$  dhe shkarkimi i gazrave  $43\text{ m}^3/\text{ore}$  kur punon me kapacitet te plote.



#### **Furra perbehet nga:**

- Dhoma e trajtimit
- Djegesii gazit
- Dhoma e shkembimit te energjise
- Ventilaret e fryrjes se ajrit
- Ventilatori i fryrjes se gazit
- Paneli elektrik

Per te rritur rendimentin ajrit qe del nga furra kalon ne nje shkembyses nxehtesie duke ngrohur ajrin e fresket qe futet ne furre deri ne temperaturen 80 °c proces i cili ben te mundur uljen e konsumit te lendes djegese e per pasoje dhe shkarkimet ne ajer.

#### **Menaxhimi i instalimit**

Menaxhimi i instalimit behet nga nje staf i trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar kete aktivitet. Perfaqesohet nga departamente te ndryshme te cilet kryejne funksionin e tyre dhe realizojne operimin e kesaj Shoqerie Konform te gjitha rregullave tatimore, fiskle, dhe atyre mjedisore.

## **6. INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK,FURNIZIMIN ME UJE,SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET,SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.**

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në **Xhafzotaj,Autostrada Durres – Tirane. Durres.**

Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjale ndodhet ne brendesi te prones dhe nuk cenon pronat e tjera perreth.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka nje qarkullim te dendur te automjeteve. Gjithashtu pozicionimi buze rruges kryesore si edhe i rrugeve hyrese dhe dalese krijon lehtësira për automjete që vine për ngarkim shkarkim.

Infrastrukturuar ne zonen e ushtrimit te aktivitetit eshte e gatshme ku perfshihen, infrastruktura rrugore, rrjeti i furnizimit me uje te pijshem, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, rrjeti i shperndarjes se internetit si edhe rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza.

Funksionimi këtij Projekti nuk do të ndikojë në dëmtimin ose devijimin e infrastrukturës ekzistuese. Në pronë sigurohet akses nëpërmjet rrugës ekzistuese e cila është e shtruar. Për të gjithë zonën e studiuar,objekti do të plotësojë nevojat e tij për ujë higjeno-sanitar nëpërmjet shfrytëzimit të rrjetit ekzistues dhe përsa i përket sistemit të shkarkimit të ujrave eshte lidhur me kanalizimet ekzistuese në zonë. Mbetjet e ngurta do të menaxhohen në bashkëpunim me **Bashkinë Durres** dhe do të përcaktohet vendi i depozitimit të tyre nga Bashkia.

Pastrimi i mbetjeve urbane do të kryhet nëpërmjet vendosjes së koshave të mjaftueshëm.

Largimi i ujrave te zeza dhe i ujrave atmosferike behet permes kanaleve deri te puseta per mbledhjen e ujrave te zeza e cila llogaritet sipas kapacitetit. Puseta vendoset ne pjesen ku me se paku i pengon aktivitetin.

Energjia Elektrike që nevojitet do te merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

Ka rrugë të mira në zonë dhe ne brendesi te Projektit, nuk do të hapen rrugë të reja per kete qellim por do te shfrytezohen ato ekzistuese.

Nuk do të ndërtohet ujësjellës i ri.

Nuk do të ndërtohet rrjet elektrik i ri.

### **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjet e gjeneruara do të grumbullohen në pika grumbullimi ose vend depozitime të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V).

Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësine e Qeverisjes Vendore dhe firmën pastruese të territorit.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim.

Mbetje janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Depozitim i mbetjeve do të bëhet në përputhje me **"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për percaktimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme".**

### **Gjendja ekzistuese e rrugëve**

Ekzistojnë rrugë aksesi përgjatë kufijve në lindje dhe në jug të projektit. Rrugët kryesore përgjatë kufirit perëndimor dhe gjatë qendrës së zonës janë të ndërtuara, ndërkohë që zona ka një plan të studiuar dhe të miratuar të infrastrukturës rrugore.

Nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja për projektin.

## **7. INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PERRETH ZONES SE PROJEKTIT**

Projekti i Subjekti **"IPNOS" Sh.p.k.** me administrator **z.Silvio Carlo Maida** do të ushtroj aktivitetin në Adresen: **Durres,Xhafzotaj,Xhafzotaj,Autostrada Durres – Tirane,Km 6, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie14/100,Vol 19,Fq 117,Prane stacionit z Zoteknik,Kodi postar 2013.**

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka një qarkullim të dendur të automjeteve. Gjithashtu pozicionimi buze rrugës kryesore si edhe i rrugëve hyrëse dhe daljeve për në aktivitet krijon lehtësira për automjete që futen në aktivitet.

### **7.1 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.**

- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të kete ndikime në ndryshimin e habitateve
- Mbetjet e gjeneruara nga punjonjësit do të grumbullohen në kazane të vecante.

Kazanet do te zbrazen rregullisht dhe mbetjet do te hidhen ne vendin e percaktuar nga Njesia Vendore per mbetjet urbane.

- Do e ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik ne pune si dhe pajisjes se punonjesve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes ne pune.
  - Mbetjet urbane te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara
  - Jane marre masa per ndricimin perreth (vendosja e impiantit te ndricimit).
  - Shoqeria operon ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe duke qene aktiviet egzistues kryen monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
  - Jane marre masa ne projekt per instalimin dhe respektimin e sinjalistikes e trafikut te cilat do te minimizonin impaktet per aksidente te mundshme.
  - Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, do te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 e mbremjes deri ne 07<sup>00</sup> te mengjesit.
  - Do te respektohen te gjitha kushtet dhe masat ne Lejen e Mjedisit qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e prishme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithë perpaesite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

## **8. INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KOSIDERATE PER SA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLLOJISE QE DO TE PERDORET.**

Kjo Shoqeri e ka filluar aktivitetin e saj ne vitin 2007.

Makinerite e linjes dhe lenda e pare sigurohet kryesisht nga Italia.

Produkti perfundimtar shkon per eksport (ka kontrata kryesisht me furnitoret e lendes se pare).

Shoqeria ka siguruar nje klientele te rregullt, cka vjen nga cilesia e mire e prodhimit.

Shoqeria "IPNOS" Sh.p.k. ndodhet ne **Xhafzotaj, Autostrada Durres – Tirane. Durres..** Kjo zone eshte e miratuar per zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe industriale.

Objekti furnizohet me energji elektrike sipas kontrates se lidhur me OSHEE.

Nje gjenerator me fuqi 120 Kw eshte disponibel per rastet e nderprerjes se energjise nga rrjeti elektrik.

Uji i nevojshem sigurohet nga njeti i ujesjellsit te qytetit.

Instalimet elektrike dhe ndricimi jane realizuar sipas standarteve bashkekohore duke lejuar nje funksionim optimal te procesit ne teresi, dhe mjaft komod dhe per punonjesit.

Linja dhe zgjidhja brenda hapësirës është projektuar mjaft kompakte duke lejuar nje zhvillim funksional te aktivitetit.

Teknologjia per prodhimin dhe mbeshtjelljen e motoreve elektrike jane teknologji me paisje bashkekohore si per kryerjen e procesit teknologjik ashtu edhe per treguesit e mbrojtjes se mjedisit sipas standarteve te Komunitetit Europian.

Funksionimi i tyre jepet ne menyre te detajuar ne pershkrimin e procesit teknologjik.

Vendodhja e objektit favorizohet nga nje infrastrukture e gatshme dhe lidhet me rrugen automobilistike, si per transportimin e lendeve te para ashtu dhe per shperndrujen e produktit te gatshem.

Gjithe njesia prodhim-magazinim eshte e vendosur ne nje hapësire te mjaftueshme per nje proces optimal. Vendosja e gjithe paisjeve te nevojshme eshte zgjidhur ne menyre racionale, funksionale dhe shume praktike, si per realizimin e prodhimit ashtu dhe per personelin punonjes.

Lenda e pare, vernike te llojit AQUATHERM BC - 365, letra e plastifikuru, teli i bakrit, struktura metalike e motorrave sigurohen nga importi dhe jane te nje cilesie shume te mire gje qe garanton realizimin e produkteve cilesore dhe brenda standartit.

Per percaktimin e vend vendosjes se projektit jane bere studime dhe matje paraprake nga vete Shoqeria, kushtet klimatike, dhe tregues te tjere te nevojshem.

Zhvilluesi **"IPNOS" Sh.p.k.** ne rolin edhe te Subjektit qe do bej permiresim te veprimtarise se vet me vendqendrim te veprimtarise ne **Xhafzotaj, Autostrada Durres – Tirane. Durres.**

Zgjidhja optimale e projektit te siguron sherbim me teknologji e me sigurim teknik.

Ane pozitive e ketij projekti eshte se, rreth tij ka ambiente banimi, familjare por megjithate projekti do ta zhvilloj aktivitetin duke u mbeshtetur ne legjislacionin e sotem te Republikes se Shqiperise per mbrojtjen e Mjedisit. Perparesi ne kete Projekt do ti jepet mbrojtjes se mjedisit nga ndotja. Per te siguruar nje mjedis te paster e pa problem per personelin e sherbimit si edhe per objekte afer aktivitetit, eshte parashikuar nje sistem kanalizimesh, tubacionesh te cilat ne bashkeveprim do te orientojne ujerat natyrale dhe ujerat e shkarkimit ne separatorete perkates.

## **9. TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.**

Gjatë funksionimit të projektit, do të nevojitet uji, energjia elektrike, uje, lende djegese si dhe produkte të konsumit të përditshëm.

**Uji** që nevojitet për zbatimin e këtij projekti është marrë nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila është caktuar nga Ndërmarrja e Ujësjellësit që e ka në përdorim linjën e Ujësjellësit. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot përkatëse në lidhje me furnizimin me ujë do të paguhet nga Shoqëria.

### **Furnizimi me energji elektrike**

Energjia Elektrike që nevojitet do të merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

**Shkarkimet e ujërave** do të lidhen me sistemin ekzistues të kanalizimeve të zonës.

**Lenda djegese** do të sigurohet nga pika e karburantit me e afert me aktivitetin.

## **10. INFORMACION MBI NDIKIMET NE MJEDIS TE PROJEKTIT**

### **10.1 Informacion mbi shkarkimet ne mjedis**

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë kryesisht pluhurat nga lëvizja e automjeteve dhe zhurmat teknologjike të paisjeve mbështjellëse të telit në mjediset e punës. Nga ky aktivitet nuk gjenerohen mbetje të ngurta të rrezikshme.

Mbetjet e gjeneruara janë vetëm mbetjet nga konsumi i përditshëm i puntorëve. Të gjitha mbetjet e grumbulluara do të dërgohen në subjektet e licensuara për trajtimin e tyre dhe të asgjësimit të tyre.

### **10.2 Ndikimet negative**

#### **Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis**

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjate ushtrimit te aktivitetit. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do vazhdoj të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh.

Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për Leje Mjedis Tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nënprojektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

### 10.3 Impakti në mjedis nga menaxhimi i tij

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me aktivitetin gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

### 10.4 Matrica e ndikimeve të mundshme në mjedis nga zbatimi i projektit.

Në tabelat e mëposhtme janë identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis të projektit sipas fazave të zbatimit të tij.

Faza operationale			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	Emetim gazesh nga automjetet dhe pluhuri për shkak të qarkullimit të tyre.	Ndikim mesatar në cilësinë e ajrit. Mund të kontrollohet dhe shmanget me masat e duhura të menaxhimit.
2	Zhurmë	Zhurmë e gjeneruar nga lëvizjet e mjeteve (makinave) dhe paisjeve ne aktivitet.	Ndikimi do të jetë normal.
3	Cilësia e ujërave	Rrjedhjet aksidentale nga automjetet	Ndikim i ulët i cili mund të kontrollohet dhe shmanget me masat e duhura të menaxhimit.



4	Toka	Rrjedhjet aksidentale nga automjetet	Sheshet e qëndrimit të automjeteve dhe e ushtrimit te aktiviteteve tersi jenë të shtruara dhe të pajisura me sistem drenazhimi, mundësia për depërtim në tokë pothuajse nuk ekziston.
5	Mjedisi socio - ekonomik	Mundësi të mira punësimi. Ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët. Gjenerim të ardhurash nga aktivitetet shtesë.	Ndikimi socio – ekonomik është përgjithësisht pozitiv.
6	Mbetjet	Aktiviteti njerezor i punonjesve Si dhe nga aktiviteti	Ndikim i ulet pasi keto mbetje grumbullohen ne koshat qe jane vendosur ne ambientet e aktivitetit Grumbullimi dhe menaxhimi nga subjekte te licensuara per trajtimin e tyre.
7	Trafiku	Do te jete ne intervale kohore	Ndikim ne rritjen e trafikut te zones ku ushtrohet aktiviteti.

## 10.5 Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave te transportit në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë aktivitetit, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar. Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme. Nivelet kufi të zhurmës në mjedise të caktuara.

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmx Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, Qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedisi urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

## 10.6 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve

### **Toka /Përdorimi i Tokës**

Kryerja e aktivitetit brënda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit.

Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

**Cilësia e ajrit /Rritje e emetimeve ne ajer nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim---shkarkimit**

Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës.

Mjete me kolaudim optimal. Plan veprimi në rast rrjedhjesh.

Përdorimi eficient i mjeteve motorrike.

Përdorim i karburanti cilësor.

Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës.

### **Sistemi i drenazhimit**

Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit,

**Mbetjet/Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.**

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.

**Zhurmat/Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve**

Përdorimi i mjeteve të kolauduara.

Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).

Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

**Trafiku Rrugor/Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve.**

Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

## 11. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në ruajtjen/magaznim, tregetim, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor "Mbrojtjen e Mjedisit", reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, Sox në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës,

Subjekti "IPNOS" Sh.p.k, ka hartuar "Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës", sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

### **11.1 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve**

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuara negative në mjedis.

Këto masa duhet të synojnë:

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së Aktivitetit;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku zhvillohet aktiviteti, si dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Plan -- organizimi në mënyrë që të mos impaktohen sipërfaqet jashtë ndërhyrjes;
- Kontrolli i mbetjeve të objektit;
- Hapja e kanaleve të nevojshëm perimetral për kullimin drejtimin e ujrave të shiut, me qëllim shmangien e ndotjes në ujëra;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës;
- Kontrolli teknik i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet tej normave të gazeve.

### **11.2 Masat zbutëse në fazën operacionale**

Per evidentimin e ndotjes nga aktiviteti do te merren masa.

### **11.3 Menxhimi i mbetje**

- Mbetjet jo te rrezikeshme do te vecohen nga komponentet e pastera dhe do te grumbullohen per nje depozitim dhe riciklim te mundshem.
- Mbetjet e rrezikeshme ne te cilat do te bejne pjese ato vajore, Vajra rrjedhese, detergjente etj, do te depozitohen ne nje kontenier te caktuar per grumbullimin e ketyre mbetjeve.

- Gjenerimi i zhurmave eshte brenda normave te lejuara dhe nuk do te kete shqetesim per banoret perreth. Eshte parashikuar edhe zona e ngadalesimit te mjetit perpara se mjetet te hyjne ne aktivitet cka minimizon edhe nivelin e zhurmave.
- Kryhet pastrimi periodik i ambjenteve te punes ne aktivitet.
- Transporti i mbeturinave behet ne oret me trafik te pakesuar.

#### 11.6 Minimizimi i ndotjes se ajrit

- Subjekti gjate kohes me temperature te larte e lage mjedisin perreth me ujin e pusit qe eshte hapur per kete qellim perreth nje deri dy here ne dite per te reduktuar çlirimet e pluhurave nga levizja e mjeteve.
- Ndotja e ajrit eshte ne nivele teper te ulta, vetem i pluhurave qe krijohen nga mjetet qe futen ne territorin e aktivitetit.
- Ndotja e ajrit eshte ne nivele teper te ulta vetem nga gazrat qe dalin nga skapamentot e makinave gjate hyrjes e daljes ne **aktivitet**.

#### 11.7 Zgjidhja e problemit te zjarrit nga shkarkesat elektrike

- Te gjitha paisjet jane te tokezuara.
- Per te gjithë sistemin e linjave lidhja elektrike e vazhdueshme do te jete me ane te urave.

#### 11.8 Mbrojtja nga Zjarri

Subjekti "IPNOS" Sh.p.k per ushtrimin e ketij aktivitet ka marre te gjitha masat e dukura ne baze te kushteve te parandalimit dhe mbrojtjes kundra zjarrit (PMKZ) per nje funksionim normal dhe pa avari te paisjeve te ndryshme ne teresi.

Paisjet e mbrojtjes kundra zjarrit per kete objekt jane te nje rendesie te vecante, dhe jane te domosdoshme si nje pike themelore e funksionimit te tij. Subjekti eshte i pajisur me nje Akt---Teknik te PMNZSH ku jane parashikuar te gjitha masat qe duhen te ndermerren ne raste te jashtezakonshme, te parandalimit te zjarrit dhe menaxhimit te situates se rrezikut te zjarrit ne raste te vecanta.

Ne zbatimin e germs b, te Nenit 34 te Ligjit Nr.8796 date 05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", Shoqeria ka marre masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku renie zjarri.

Per mbrojtjen nga Zjarri ne Subjekt jane marre masat e meposhteme:

- Ka fikse zjarri me shkume dhe pluhur.
- Ka rregullore te brendeshme te PMNZSH-se.
- Personeli eshte i instruktuar me rregullat e PMNZSH-se.

- Automjeti Zjarrfikes afrohet nga te tre anet e objektit.
- Jane vendosur bombola zjarrfikese ne ambjentet e punes.
- Ne menyre periodike behet kontrolli i paisjeve dhe i mjeteve te MNZ si dhe behet kualidimi i tyre ne menyre qe te parandalohet rreziket e mundeshme.
- Jane vendosur tabela per mbrojtjen nga zjarri, si dhe per perdorimin e zjarrshuarsve ne rast aksidente nga zjarri ne piken e karburantit.
- Per tu mbrojtur nga ndonje zjarri i mundshem qe mund te bjere jane ruajtur largesite mbrojtese ndaj zjarrit duke ruajtur largesine e godines dhe objekteve perreth.
- Jane lene distancat e percaktuara per rruge kalim te automjeteve, zjarrefiksive.

Ky subjekt ushtron prej vitesh aktivitetin konform te gjitha ligjeve dhe dispozitave ligjore qe kane te bejne me ushtrimin e ketyre aktiviteteve. Gjate kesaj periudhe ky subjekt ka zbatuar me korrektesi te gjitha dispozitat ligjore, kushtet teknike te punes, duke krijuar edhe nje mjedis bashkekohor per kete lloj aktiviteti.

### **11.9 Masat per mbrojtjen e mjedisit**

Masat per mbrojtjen e mjedisit qe jane marre nga ana e subjektit jane:

- Rregullimi, sistemimi dhe rrethimi i territorit.
- Instalimi i sistemit te ndarjes se ujrave te kanaleve te grumbulluara nga kanalet siperfaqesore te objektit.
- Jane bere kanalizimet e brendeshme te objektit te lidhura me tubacionin kryesor qe shkarkohet ne kanalin prane objektit.
- Ujjerat sanitare jane lidhur me rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone.
- Ne kanalizimin e zones derdhen vetem ujerat e shiut.
- Mbetjet e ngurta jo te rrezikeshme qe do te krijohen do te grumbullohen dhe periodikisht nga stafi i punes do te perfundojne ne kontenieret e zones e me pas me ane te sherbimit te transportit te mbetjeve nga Bashkia do te shkojne ne landfillin e zones.
- Projekti perputhet me Planin e Pergjithshem Vendor te Bashkise miratuar nga KKT, ku ky objekt eshte i ndertuar me leje ndertimi te miratuar.

### **11.10 Masat Parandaluese**

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë proceseve te ndryshme ne aktivitet.
- Minimizimi dhe evidentimi i zhurmave te mundshme.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.

- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjithë instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk eshte e nevojshme perdorimi i tyre dhe ruajtja e distances së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës,
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbatja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

#### **11.11 Masat Kontrolluese**

- Pastrimi i ambjenteve ku zhvillohet aktiviteti.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e Shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive dhe paisjeve.
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

#### **11.12 Masat Nderhyrese**

- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjesimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjente të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.

- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/ makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së aktivitetit me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjëhershëm i automjeteve dhe njërive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Teritori ku ndodhet aktiviteti mbahet pastër por dhe ne rast se do te kete ndotje e mjedisit ose demtim te tije do te marre masa per rehabilitimin e tij si ne gjendjen e meparshme.

#### **11.13 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve:**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.



- Përcaktimi i vend---parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të transferimit të mbetjeve
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno---Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra---kartona,si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjetëruara. Mjedis i gjëlëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro---mjedisore të nevojshme.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjetëruara. Mjedis i gjëlëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro---mjedisore të nevojshme.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin për ruajtjen/magazinimin transferimin e mbetjeve.

## **12. PROGRAMI MONITORIMIT**

### **12.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor**

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

## 12.2 Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku zhvillohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

## 12.3 Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për tregetimin me pakice të karburanteve dhe GNL, i pozicionuar në Zona Uranë nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në sheshin e transferimit por dhe në një zonë mbi 50 m për rreth sheshit ku do të zhvillohet aktiviteti.

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimi i parametrave tekstin të instalimit.
- Monitorimi i zonës së mundshme të gjenerimit të aromave gjatë zhvillimit të veprimtarisë
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura në sipërfaqen e aktivitetit

#### **12.4 Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.**

Do te kryhet monitorimi i pluhurave, i zhurmës cilesise se ujrave megjithëse ne kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor.

- Ne Subjekt respektohen standardet e normativat per nivelin e zhurmave te lejuar ditën, per vete llojin e aktivitetit qe kjo zhurme mund te krijohet nga aktiviteti dhe ne raste te rralla, vetem gjate ndezjes se gjeneratorit.
- Brenda teritorit te aktivitetit relativisht mund te kete zhurme qe mund te ndikojne vetem ne shendetin e punonjesve, por jo ne ambientin perreth per aktivitetet e tjera apo per banoret perreth.
- Ambienti ku ushtrohet aktiviteti eshte i sheshte dhe i projektuar mire, nuk ka rritje te nivelit te zhurmave dhe nuk ndikon ne shendetin e punonjesve.
- Do te behet menaxhim me i mire i instalimeve dhe paisjeve per te mos pasur ndotje akustike dhe ndotje termike jashte normave te lejuara.
- Zhurma eshte nje tingull i padeshiruar, dhe sidomos gjate punes, por qe nuk i kemi kaluar ato te normave te lejuara per punen ditën, deri tani nuk kemi pasur ankese nga individe apo subjekte prane aktivitetit tone qe ti kemi shqetesuar per zhurme, megjithate jemi te hapur per te pritur çdo ankese te ketij lloji apo tjeter.

Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

#### **Planet e sigurisë dhe të menaxhimit të katastrofave hipotetike**

- Plani i evakuimit të njerëzve në raste alarmi (emergjence),
- Procedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik,
- Procedurat e mjekimit dhe të ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë,
- Emrat e personave të kontaktit dhe numrat e tyre të telefonit,

- Procedurat e nënshtrimit apo fikjes së zjarrit,
- Plani i sigurisë së rrjedhjeve të mundshme të naftës apo lubrifikantëve,

Shoqeria "IPNOS" Sh.p.k ka realizuar nje program te monitorimit nga specialiste qe do te marrin ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Ne aktivitet duhet te jene ne gjendje gadishmerie prozhektoret dhe mjete te fuqishme ndricimi,mjetet e fikjes se zjarrit,uniformat anti-zjarr per personelin,i cili duhet te kete bere trajnimin e nevojshem per te tilla raste per te vepruar me shpejtesi dhe korrektesi.

Per sa me siper eshte e mundur qe te perzgjidhen per tu monituruarnga vete investitori ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, regjistrohen dhe pastaj komunikohen ne Instancat Shteterore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK

LEJE NDERTIMI

Nr. Prot. 2660/1 datë 24.07.2019

I JEPET ZHVILLUESIT : **Arjan Tivari dhe Klarita Tivari.**

DHE INVESTITORIT: **Arjan Tivari dhe Klarita Tivari.**

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN : **"Rikonstrukcion, shtesë anësore dhe shtesë kati "**

Miratuar me Vendim nr. 175 të Kryetarit të Bashkisë Shijak datë 24.07.2019

ADRESA E REALIZIMIT TE PUNIMEVE: Njësia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak.

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË DERI NË DATËN 24.07.2022

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit.
2. Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve.
3. Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër mjedisi përreth.
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike, sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohet shqetësime në rrjetin publik.
5. Të respektohen normat dhe standardet e percaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.
6. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë paraprakisht bashkinë për fillimin e punimeve si dhe të komunikojë emrat e zbatuesit, mbikqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, së bashku me licensat profesionale përkatëse. Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme.
7. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e Kontrollit të Zhvillimit dhe Inspektorati Ndërtimor pranë njësisë vendore.
8. Afati i fillimit të punimeve është 1 vit nga data e lëshimit të kësaj leje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
9. Nëse ndërtimi vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme.
10. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. **Zhvilluesi, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht në rast kryerje punimesh në shkelje të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.**
11. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë 36 mujore nga data e lëshimit të saj, referuar grafikut të punimeve.
12. Zhvilluesi është i detyruar që, pas përfundimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij, të kërkojë nga Bashkia që të lëshojë çertifikatën e përdorimit të tij.

**KRYETARI**  
**Ardian Kokomani**  
Ardian  
Kokomani

Detyrues i bashkisë së Shijakut  
Shënim: Nëse kjo lejeje nuk është miratuar nga bashkia, nuk mund të përdoret.  
Data: 2019.07.24 14:00:00 +01:00

Adresa: Lagjia "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMUNA XHAFZOTAJ  
DURRES

KONTRATE

PER SHERBIMIN E PASTRIMIT TE MBETJEVE NE REPARTET E SHOQERISE "Ipnos" Shpk

Ne Durres , sot ne daten 25/02/2021, u lidh kjo kontrate sherbimi midis paleve:

- **Ofruesi i Sherbimit:** Shoqeria "S.A.R.R Societa Albanese Realizzazione Recupero" Sh.p.k, me NIPT: L21704502K , perfaqesuar nga Administratori i saj Z.Alush Xhahani ,i cili me poshte do te quhet **ofruesi, Dhe**
- **"Ipnos" sh.p.k** me seli ne Autostraden Durres-Tirane Km.6, Xhafzotaj, Durres e regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit, me Nipt **M02306026C**, me administrator Z.Silvio Carlo Maida, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e meposhte do te quhet **"Perfituesit e sherbimit"**

*Me ane te kesaj Kontrate Sherbimi, palët do të zgjidhin efektet juridike të veprimeve juridike të nënshkuara mes tyre, të cituara në kushtet paraprake të kesaj kontrate, si dhe të cdo lloj veprimi juridik të nënshkuar prej tyre.*

Baza ligjore e kontrates: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, 'PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE, Ligjit Nr.8934, datë 05.09.2002 'PËR MBROJTJEN E MJEDISIT', Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Rregulloren "Mbi Administrimin e Mbeturinave Urbane" te miratuar nga Keshilli Bashkiak i qytetit perkates dhe akte te tjera Ligjore ose nenligjore.

**Palet bien dakort si me poshte:**

**Objekti i kontrates**

**Neni 1**

Objekti i kesaj kontrate eshte grumbullimi dhe pastrimi i mbeturinave teknologjike dhe mbetjeve urbane ne territorin e shoqerise Ipnos shpk.

**Afati dhe vlera e kontrates**

**Neni 2**

1. Ky sherbim do te ofrohet per nje periudhe kohore **12 muaj** nga data e hartimit te kesaj kontrate.
2. Palet kane te drejten e rinovimit te kontrates pas perfundimit te ketij afati. N.q.s palet nuk shprehen ndryshe, me shkrim brenda 30 diteve nga perfundimi i kontrates, kontrata rinovohet per te njejtin afat te parashikuar ne piken 1.
3. Ky sherbim do te kryhet nga ofruesi kundrejt tarifes prej **20.000 lek/muaj (pa perfshire TVSH) per pastrimin e nje kontenitori mbetjesh nje here ne jave ne formen dhe menyren e pageses se rene dakort nga perfituesit e sherbimit.**

**Detyrat e ofruesit**

S.A.R.R  
L21704502K  
SHIJK DURRES-ALBANIA

### Neni 3

1. Ofruesi garanton pastrimin e mbetje si mbetje teknologjike, plastmas, karton, plastike etj.
2. Pastrimi dhe zhvendosja e mbetjeve do te behet me mjetet e zoteruara nga ofruesi i sherbimit.
3. Ofruesi garanton pastrimin e kontenerit rregullisht dhe ne kohe. Heqja e mbetjeve nga kompatoret do te behet minimalisht nje here ne jave, nga ora 08.30 deri ora 15.30.
4. Ofruesi deklaron se posedon makinerite dhe punonjesit per kryerjen e sherbimit te kesaj kontrate dhe gjithe dokumentacionin (Leje, Certifikata, Autorizime, Marreveshje etj) qe kerkoet per kryerjen e ketij sherbimi.

### Detyrat e perfituesit te sherbimit

### Neni 4

1. Perfituesi marrin persiper ruajtjen dhe ndarjen e mbetjeve, duke i depozituar ato ne vendgrumbullimin e paracaktuar ne territorin e tij.
2. Perfituesi paguan, nepermjet bankes, brenda 10 diteve nga data e leshimit, te fatures tatimore te sherbimit ne llogarine bankare te ofruesit ne
  - i. ProCredit Bank me NR. IBAN : AL34209122400000240341220001 Swift: FEFAALTRXXX;
  - ii. Intesa SanPaolo me NR..IBAN: AL34208121190000079788035301 Swift: USALALTRDR2;
  - iii. BKT me NR. IBAN: AL2320512644000941CLPRCLALLA Swift: NCBAALTX.
  - iv. CREDINS me NR.IBAN:AL97212122370000000000384871 Swift: CDISALTRXXX.
3. Perfituesi njofton me telefon apo poste elektronike, per çdo nevojë të shpejtë në lidhje me sherbimin e pastrimit.

### Dispozita te tjera

### Neni 5

1. Per çdo mosmarrveshje te lidhur me kushtet e mesiprme, palet bien dakort ne zgjidhjen me mirekuptim te tyre, me njoftim paraprak dy muaj perpara, ne te kundert do t'i drejtohen organeve kompetente.
2. Detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga kjo kontrate fillojne efektet e tyre nga moment i nenshkrimit te kesaj kontrate. Kontrata perpilohet ne 3 (tre) shtypshkrime te barasvlefshme, ne gjuhen shqipe, me permbatje te njejte ligjore. Palet e lexuan te plote Kontraten e gjeten te shkruar sipas vullnetit te tyre dhe e nenshkruan duke pranuar plotesisht te drejtat dhe detyrimet mes tyre.

### PALET

Perfituesi i sherbimit Ipnos Sh.p.k

Administratori



S.A.R.R  
L21701502K  
S.H.I.J.A.K DURRES - ALBANIA  
S.A.R.R Sh.p.k  
Administratori


Alush Xihani













### **13. INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.**

Shoqeria **"IPNOS" Sh.p.k.** me administrator z. **Silvio Carlo Maida**, eshte i regjistruar ne QKR me date 05.11.2020, dhe eshte pajisur me çertifikaten e regjistrimit si person juridik, me numer

**NIPT M 02306026 C**, si dhe ka dokumentacionin e kontratave qe ka lidhur per furnizimin me uje dhe energji eletrike.ku midis veprimtarive te tjera ka dhe **"Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."**

Subjekti do ndjek te gjitha procedurat ligjore per tu pajisur me lejet perkatese per funksionimin konform te gjitha rregullave te ketij projekti.

**Nisur nga sa u paraqit me lart dhe ne dokumentacionin perkates shoqerues, perfundimisht mund te themi se projekti i Subjektit "IPNOS" Sh.p.k. per piken ID 9.2," Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë."ne Xhafzotaj,Autostrada Durres – Tirane ,Durres me administrator z.Saimir Balliu nuk do te sjelle pasoja negative per mjedisin e zones.**

**Si perfundim mund te themi se projekti qe do te ndertohet konsiderohet i pershtatshem dhe i pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore per zonen perreth.**

**Hartoi materialin  
STUDIO MJEDISORE  
"DEA PROJEKT"Sh.p.k.  
Eksperti i Vlersimit e Auditimit Mjedisor**

**ARJAN BALA**

**Çertifikuar nga Ministria e Mjedisit  
Nr. 11594 Prot, Nr. identifikus 197, date 10.12.2014**